Bashkia Administrata + Njësitë Administrative Viti 2024	12,503,117
	12,572,134

Në llogarinë 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatime dhe taksa" shuma prej 6,210,978 lekë

Bashkia Administrata + Njësitë Administrative	4,181,599
Institucioni Dega Ekonomike e Kulturës	
Institucioni Ndërmarrja e Përgjithshme e Punëve Publike	614,915

Institucioni	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	599,046
Institucioni	Drejtoria MZSH	315,563
Institucioni	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	
Institucioni	Institucioni Shtëpia e Foshnjës	95,960
Institucioni	Institucioni Shtëpia e Fëmijës shkollor	139,159
Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	264,736
		6,210,978

Në llogarinë 4341 Të tjera operatione me shtetin (Kreditor) me një saldo kreditore prej 876,213 lekë përfshihen :

Drejtoria Ekonomike e Arsimit	876,213
	876,213

Në llogarinë 435 "Sigurime shoqërore" shuma prej 19,345,081 lekë

	Bashkia Administrata + Njësitë Administrative	12,595,097
Institucioni	Dega Ekonomike e Kulturës	0
Institucioni	Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve	0
Institucioni	Drejtoria e Përgjithshme e mirëmbajtjes së objekteve publike	3,328,827
Institucioni	Ndërmarrja e Përgjithshme e Punëve publike	1,318,367
Institucioni	Drejtoria MZSH	541,163
Institucioni	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	
Institucioni	Institucioni Shtëpia e Foshnjës	316,565
Institucioni	Institucioni Shtëpia e Fëmijës shkollor	458,236
Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	786,826

19,345,081

Në llogarinë 436 "Sigurime shëndetësore" shuma prej 2,409,272 lekë

	Bashkia Administrata + Njësitë Administrative	1,765,177
Institucioni	Ndërmarrja e Përgjithshme e Punëve publike	149,411
Institucioni	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	216,727
Institucioni	Teatri "Migjeni"	0
Institucioni	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	0
Institucioni	Drejtoria MZSH	61,331
Institucioni	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	0
Institucioni	Institucioni Shtëpia e Foshnjës	43,931
Institucioni	Institucioni Shtëpia e Fëmijës shkollor	63,590
Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	109,105

Në llogarinë 467 "Kreditore të Ndryshëm" me një saldo kreditore prej 53,610,160 lekë përfshihen :

Kreditore të ndryshëm Bashkia 53,211,847

Drejtoria Ekonomike e Arsimit 0

Dega Ekonomike e Kulturës 0

Teatri 0

Migjeni 0

Drejtoria Kopshte Çerdhe 0

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi 0

Qendra Zhvillimi 238,444

Shtëpia e 105,215

Foshnjës

Shtëpia e Fëmijës Shkollor 54,654

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe 0

Shpëtimi

53,610,160

Në llogarinë 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" me një saldo kreditore prej 98,198,113 lekë përfshihen :

Bashkia - NJA 87,381,377

Drejtoria Ekonomike e Arsimit 7,140,850

Dega Ekonomike e Kulturës 686,077

Teatri 62,481

Migjeni

Drejtoria Kopshte Çerdhe 372,401

Ndërmarrja e Përgjithshme e Punëve publike 2,389,015

Drejtori e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjorë 90,001

Drejtoria e Përgjithshme e mirëmbajtjes së objekteve publike 75,911

98,198,113

Në llogarinë 470 Llogari në pritje - Të ardhura për tu marrë 2,094,107,666 lekë përfshihen :

Të ardhura të regjistruara në llogarinë debitoare të ndryshëm

Bashkia 2,094,107,666

2,094,107,666

Në llogarinë 26 Pjesëmarrje në kapitalin e vet me vlerë 1,115,074,910 përfshihen :

Shoqëritë	Pjesëmarrja e Aksioneve	Vlera e kapitalit
		Bashkisë
		Shkodër

Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta – Perime	100 % të aksioneve	85,658,098
Ujësjetllës Kanalizime Shkodër	100 % aksione	863,468,000
Parku i Udhëtarëve Shkodër	60 % të aksioneve	13,944,000
Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës –Kanalizime Shkodër	36% e aksioneve	14,053,000
Ndërmarrja “BIO STRAJCA	100 % aksione	10,000,000
Ndërmarrja e trajtimit të Studentëve	100% Aksione	127,951,812

II. DETAJIMI I DETYRIMEVE TË PALIKUIDUARA NË FUND TË VITIT BUXHETOR 2024

Në fund të vitit 2024 kemi një gjendje detyrimesh në shumën prej 163,829,020 lekë shumë e cila përbëhet nga :

Llogaria	Emërtmi	Bashkia + Institucionet
40	Furnitorë e llogari të lidhura me to	12,572,134
42	Personeli e llogari të lidhura me to	68,805,182
431	Shteti tatim-taksa	6,210,978
435	Sigurime shogerore	19,345,081
436	Sigurime shëndetësore	2,409,272
467	Kreditorë të ndryshëm	53,610,160
4341	Operacione me shtetin(detyrime)	876,213
	Totali	163,829,020

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Ju, sqarojmë se sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 35, datë 29.12.2023, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 40, germa “h”, detyrimet e Bashkisë Shkodër janë krijuar në vite, si rrjedhojë e keqmenaxhimit të financave nga ish Komunitat (Njësitë Administrative), kjo në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 15 datë 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk të vitit 2015 të Bashkisë Shkodër”, Bashkia Shkodër, ka trashëguar nga ish-komunitat detyrime për vendime gjykatë të formës së prerë ose në proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetëm me kontrata.

Për vitin 2024, Bashkia Shkodër, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresat si më poshtë:

- Shkresë nr 10438 prot, datë 16.05.2024 me objekt “Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Prill 2024 për situatën e gjendjes financiare të Bashkisë Shkodër”.
- Shkresë nr 19217 prot, datë 27.09.2024 me objekt “Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Gusht 2024 për situatën e gjendjes financiare të Bashkisë Shkodër”.
- Shkresë nr 2825 prot, datë 13.02.2025 me objekt “Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2024 për situatën e gjendjes financiare të Bashkisë Shkodër”.

Bashkia Shkodër nuk ka stok të regjistruar në sistemin informatik të qeverisë.

Sipas ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, janë katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Bashkia Shkodër është bashki që nuk ka detyrime, e ka nivelin e stokut të papërfillshëm dhe është në gjendje shumë të mirë financiare.

Në ligjin nr. 68/2017, përcaktohet se: “Rastet sipas gjendjes financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore” (Aneksi 1) dhe “Treguesit fiskal të konsoliduar të NJVQV” (Aneksi 2), janë dy tabelat që do raportohen një herë në katër muaj në Ministrinë e Financave, së bashku me raportin e monitorimit.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpenz ime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenz ime > 25%	Stoku i borxhit afatgjatë dhe detyrimeve/Shpenz ime > 80%	Stoku i borxhit afatgjatë dhe detyrimeve/Shpenz ime > 130%

Sqarojmë se Bashkia Shkodër ka likuiditete, fonde disponibël, por përse kohë që procedurat janë me mungesë dokumentacioni, si dhe procese gjyqësore të cilat janë në proces, këto procedera nuk mund të regjistrohen si detyrime të prapambetura, por të gjitha këto detyrime janë të pasqyruara në bilanc.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM

III.1. AUDITI I BRENDSHËM

Veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është bazuar në 114/2015 “Per Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar VKM Nr. 83, datë 03.02.2019 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, Urdhërin e Ministrit të financave nr. 100 datë 25.10.2019 “Për miratimin e manualit auditimit brendshëm në sektorin publik, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në Sektorin publik”.

III.1.1 . Organizimi i Njesisë së Auditimit - Bashkia Shkodër.

Analiza e programeve të AB për periudhën raportuese: Për vitin 2024, janë planifikuar për auditim 13 subjekte, nga të cilat pesë subjekte për auditim përputhshmërie, 1 auditim i teknologjisë dhe informacionit si dhe 7 subjekte për auditime të kombinuara.

Gjatë vitit 2024, janë kryer 8 misione auditimi, ndërsa janë në proces 2 subjekte të cilat do të përfundohen gjatë vitit 2025.

Plani vjetor për vitin 2024 ka patur dy ndryshime, ku me kërkesë të Kryetar i Bashkisë, është bërë rishikim i planit vjetor, duke bërë zëvendësim i misionëve të auditimit. Për subjektet që kanë qënë të planifikuara për vitin 2024, por nuk janë audituar për arsye të kërkesës për ndryshim, janë planifikuar të kryhen gjatë vitit 2025.

Analiza e misioneve të AB: Për të gjitha misionet e auditimit të kryera gjatë vitit 2024, janë ndjekur procedurat standarde të përcaktuara nga manuali i auditimit, përfshirë njoftimin paraprak (10 dite para fillimit misionit auditimit), përpilimi i autorizimit, marrja e informacionit paraprak të organizatës, takimi me drejtuesit e organizatës dhe rënia dakord për realizimin e auditimit, përpilimi i projekt e programit auditimit, ndarja e detyrave të auditëve, përpilimi i projektit dhe raportit final të auditimit, takimi pajtues me drejtuesit e njësisë audituar, përpilimi i memorandumit, ku në menyre të përmbledhur është informuar Kryetari i Bashkisë.

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre: Njësia e Auditimit që në fazen e planifikimit ka bërë evidentimin dhe vlerësimin e riskut, bazuar në objektivat e auditimit, ku gjatë përpilimit të programeve të angazhimit, fushave të vlersuara me risk të lartë e të mesëm i është dhënë përparësi.

Për vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nga ana jone është përpiluar një pyetësor i detajuar me pyetje të cilat përfshijnë veprimtarinë kryesore të subjekteve të audituara. Mbi bazën e pyetësorit janë përcaktuar drejtimet e auditimit për monitorimin e menaxhimit financiar.

Rezultatet e auditimit: Nga kryerja e misioneve të auditimit për vitin 2024, janë konstatuar gjetje të cilat janë argumentuar me bazë ligjore si duhej të ishin kryer procedurat e punës, si janë kryer në fakt procedurat , si dhe janë dhënë rekomandimet me afate për përmirësimin e punës .

Gjate vitit 2024 në kryerjen e misioneve të auditimit janë konstatuar 134 gjetje, nga të cilat 49 gjetje sistemi i prokurimeve , blerje dhe investime, 9 gjetje paga e shpërblime 1 gjetje sigurime, 1 gjetje sistemi i tatimeve, dhe 74 gjetje të tjera.

Zbatimi i rekomandimeve: Për vitin 2024, bazuar në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e punës në subjektet e audituara janë dhene 108 rekomandime. Subjektet e audituara kanë pranuar rekomandimet e propozuara.

Njësia e Auditimit me shkresën nr. 396 date 10.01.2025, ka kërkuar informacion për realizimin e rekomandimeve për të gjithë subjektet e audituara në vitin 2024 dhe bazuar në këto informacione, ka përcaktuar realizimin e rekomandimeve.

Rekomandimet e lëna në vitin 2024 janë audituar gjatë muajit Mars 2025 dhe është hartuar raport i veçantë për realizimin e tyre.

III.2 AUDITIMI I JASHTËM

- Me shkresë 630/5 prot., datë 3.05.2024 “Njoftim Fillim Projekt Auditimi (Hyrë me nr. 9515 prot., datë 7.05.2024) Objekti “Cilësia e ujrave dhe plazheve”, Me shkresë

630/16 prot., datë 15.01.2025 (hyrë me nr.prot 9515/1, datë 16.01.2025) dërgon “Program auditimi përformance”).

- Me shkresë 770/6 prot., datë 01.07.2024 KLSH dërgon Njoftim program Auditimi me objekt “Menaxhimi i Hapësirave Publike në plazhe”. Me shkresë 770/8prot., datë 01.10.2024 dërgon “Program Auditimi Përformance “Menaxhim i hapësirave Publike”
- Me shkresë nr.1370 prot., datë 13.11.2024 KLSH-Program Auditimi Tematik me Objekt: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditin e mëparshëm të evidentuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”.
- Me shkresën NR.1370/24 prot., datë 28.01.2025 dërgon “Projekt Auditim tematik” (hyrë me nr.27081/3 prot., datë 29.01.2025.
- Me shkresë nr.1090 prot.,datë 06.09.2024 (hyrë me nr.17896 prot., datë 09.09.2025) KLSH dërgon “Fillim auditimi” .
- KLSH “Program Auditimi” me shkresë 1090/1 prot., datë 11.09.2024 (hyre në Bashki me nr.17896/1 prot., datë 11.09.2024).
- KLSH me shkresë 10902/1 prot., datë 28.01..2025, hyrë në Bashki me nr.prot. 17896/4 prot., datë 30.01.2025 dërgon “Projekt Auditimin”.

IV. MASAT E MARRA GJATË VITIT PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË NJËSI DHE PLAN VEPRIMI PËR TË ARDHMEN

Në kuadër të përmirësimeve të vazhdueshme për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit, në përputhje dhe me gjetjet për këtë fushë, janë përmirësuar si më poshtë:

- Zhvillimi i planifikimit strategjik, sidomos në kuadër të koordinimit të planifikimit strategjik dhe atij operacional, lidhjes së objektivave strategjike dhe programeve, si dhe të parashikimit të fondeve të nevojshme financiare për implementimin e tyre.
- Zhvillimin i konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe krijimi i parakushteve me qëllim përcaktimin e autoriteteve dhe përgjegjësive të qarta për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore në mënyrë objektive.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i mekanizmave të kontrollit, veçanërisht në proceset e ciklit të buxhetit, duke përfshirë proceset e planifikimit, programimit, dhe ekzekutimit të planeve financiare, si dhe në procesin e prokurimit dhe kontraktimit, duke theksuar kryesisht zhvillimin e kontrolleve ex-ante (për shembull: kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të ndikimit të projekteve të propozuara mbi fondet publike, apo përcaktimin e kriterëve të qarta për alokimin e fondeve, etj) dhe kontrolleve ex-post (si kontrolle në vend, etj.).

- Kryerja e vetëvlerësimit periodik të sistemit të kontrollit të brendshëm nga ana e nivelit të lartë menaxherial të njësisë publike, për identifikimin e mangësive të mundshme dhe zbatimin e kontrolleve më efektive.
- Realizimi i programeve të trajnimeve gjithëpërfshirëse për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumentave të kontrollit të brendshëm.
- Hartimi dhe miratimi nga ana e njësisë publike të procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performace dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.
- Hartimi i planeve operationale të konsoliduara të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Përdorimi i mundësisë së delegimit si një element i rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe realizimin me efektivitet të funksioneve të nivelit të lartë menaxherial.
- Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.
- Përfshirja në takimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

V REKOMANDIME TE PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDËSHËM

Për të siguruar përmbushjen e objektivave të institucionit të Bashkisë Shkodër për një menaxhim sa më efektiv të burimeve publike dhe pas analizës së bërë në kuadër të kontrollit të brendshëm:

Rekomandojmë :

- Vlerësimin e mundësisë së riskut për mashtrime dhe kryerjen e vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve nga ana e njësisë publike, në mënyrë që vlerësimi i riskut të mashtrimit të bëhet pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të njësisë publike në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e korrupsionit dhe mashtrimit, në rastet e shkeljeve të sinjalizuara.
- Ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.

- Kryerjen e procedurave standarde të veprimit sipas drejtorive, sektorëve, njësive për procese të tjera përveç atyre që kemi si institucion etj.,
- Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.
- Angazhimin e audituesve të brendshëm në vlerësimin e proceseve të vendimmarrjes, vendimeve strategjike dhe operacionale, mbikëqyrjen e menaxhimit të riskut, promovimin e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda organizatës, sigurimin e menaxhimit efektiv organizativ të performancës dhe llogaridhënies.
- Angazhimin e audituesve të brendshëm në vlerësimin e risqeve më të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e projekteve dhe programeve për arritjen e objektivave strategjike të njësive publike.
- Monitorimin në vazhdimësi nga njësitë e auditimit të brendshëm i nivelit të zbatimit dhe cilësinë e rekomandimeve të dhëna, me qëllim që realizimi i shërbimit të auditimit të shihet si vlerë e shtuar nga titullari e njësisë publike dhe të gjithë grupet e interesit.
- Bashkëpunimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të menaxhuar programe sa më cilësore të trajnimit të vijueshëm profesional duke përfshirë në program tema që zhvillojnë kapacitetet profesionale të audituesve të brendshëm;
- Hartimi i strategjisë së menaxhimit të riskut (plani i menaxhimit të riskut), dhe plani i veprimit për minimizimin e risqeve , për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre. Gjatë takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik të trajtohen problematika që lidhen me MFK-në duke e shtrirë fokusin në vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi.
- Përditësimin e rregulloreve të brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të njësisë publike dhe me bazën rregullatore të kontrollit të brendshëm.
- Në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe procedurave ekzistuese të punës, ndërtimin e hartave dhe manualeve të proceseve të punës dhe konsolidimin në një dokument të vetëm.
- Hartimin e planit vjetor të punës të konsoliduar për të gjithë institucionin duke përcaktuar qartë linjën e raportimit.

VI .SPONSORIZIMET PËR VITIN 2024

Për vitin 2024 Bashkia Shkodër ka marrë sponsorizime në natyrë në shumën **52,044,072 lekë** si më poshtë vijon:

Nr	Pershkrimi	Vlera
1	Shoqata VURR & VLAM ALBANIE Belgjikë (Pajisje për shërbimin zjarrfikës)	207,981
2	Shoqata VURR & VLAM ALBANIE Belgjikë (Makinë zjarrfikëse)	100340
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Dhurime stola , ilqe)	1,224,000
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Dhurime varka)	2
5	World Vision (Dhurime mjete shkollore)	62,882
6	Ar NETwork (Dhurim telefon celular)	20000
7	Shoqëria Fusha SHPK (Dhurim automjet)	450,000
8	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (artikuj elektrik , hidraulik)	31,642,333
9	Organizata the Door(dhurime llampa solar për familjet në nevojë)	93,407
10	Shoqata Volontariato internazionale per il Sviluppo (VIS ALBANIA)	1,754,522
11	Kernic Louis Erickson(Dhurim mikroçipa për qenj)	240,000
12	Nalas Dega Shqiperi(kompjuter , libra)	140,931
13	C.C.S Tiranë (Projektor për kinemanë)	7,496,600
14	DRRMSH Tiranë Dhurime ushqime nga rezervat e shtetit	1,025,956
15	DRRMSH Tiranë Dhurime ushqime nga rezervat e shtetit	496,980
16	DRRMSH Tiranë Dhurime ushqime nga rezervat e shtetit	114,372
17	Ministria e Brendshme (Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile , kancelari)	75,350
18	Ministria e mbrojtjes Reparti ushtarak 40 40 (Ndërtim Ura Guri I Zi)	6,898,416
		52,044,072

Donacione /Sponsorizime totale ne vlerë për vitin 2024, në shumën prej 2,362,432
PROJEKTI HOLD ON .

VII. TREGUESIT FINANCIARË QË PUBLIKOHEN.

BURIM FINANCIMI FONDET E VETA DHE TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

Nr.	Treguesit kyçë financiarë	Kuptimi	Formula	VITI 2024
1	Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme	Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave—raporti tregon sesa shpenzon njësia për ofrimin e shërbimeve publike. Tregon marrëdhënien midis flukseve hyrëse të të ardhurave me flukset dalëse të shpenzimeve.	Shpenzimet e përgjithshme / Të ardhurat e përgjithshme	68%
2	Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave vendore të përgjithshme	Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Rritja e raportit në vite tregon se njësia nuk mbështetet vetëm në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)	Të ardhura nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	21%
3	Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj planit të tyre	Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë është e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.	Të ardhura faktike nga taksat & tarifatat vendore / Të ardhura të planifikuara nga taksat & tarifatat vendore	104%
4	Raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Një normë e lartë një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore. Rritja e raportit përgjatë viteve mund të shpjegohet edhe me shërbime shtesë, infrastrukturë e re, pasuri të paluajtshme të shtuara, funksione të reja të marra që kanë nevojë për investime etj.	Shpenzimet kapitale / Shpenzimet e përgjithshme	12%

5	Raporti i shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Rritja në vite e peshës së shpenzimeve të personelit ndaj shpenzimeve të përgjithshme mund të tregojë ulje të shpenzimeve për investime/operative, ose faktin se produktiviteti i personelit është në rënie. Një rritje e këtij raport mund të tregojë gjithashtu se qeveria po ofron më shumë shërbime (duke marrë funksionet të reja, duke rritur volumin e shërbimeve ose cilësinë e tij).	Shpenzimet e personelit / Shpenzimet e përgjithshme	28%
6	Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale	Rritja në vite e peshës së shpenzimeve të korrente ndaj shpenzimeve të përgjithshme mund të tregojë ulje të shpenzimeve për investime/operative. Një rritje e këtij raport mund të tregojë gjithashtu se qeveria po ofron më shumë shërbime (duke marrë funksionet të reja, duke rritur volumin e shërbimeve ose cilësinë e tij).	Shpenzime korrente / Totali shpenzimeve	60%
7	Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	Rritja në vite e peshës së shpenzimeve në politikat sociale ndaj shpenzimeve të përgjithshme mund të tregojë ofrim me te larte të shërbimeve sociale ndaj komunitetit. Një ulje e këtij raport mund të tregojë gjithashtu se qeveria po ofron më pak fonde për shërbime sociale dhe konkretisht pagesë individëve për pagesë paafësie dhe familje me situatë ekonomike jo të mirë.	Shpenzime në politikat sociale / totalit të shpenzimeve	34%
8	Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	Tregon aftësinë e njësisë vendore për të respektuar subjektet dhe kryerjen e likuiditeteve në kohë. Rritja e detyrimeve të prapambetura si % kundrejt të ardhurave në fund të vitit tregon një situatë negative në lidhje me likuiditetet	Shuma e detyrimeve të prapambetura / totalit të të ardhurave	0%
9	Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të përgjithshme	Afatgjatë mbi një vit Një raport i ulët tregon që NJQV-ja është në gjendje të paguajë detyrimet e saj të borxhit (principali plus interesat). Nëse NJQV-ja po pague një përqindje të lartë të të ardhurave totale në shërbimin e borxhit, ato mund të detyrohen të ulin shërbimet e tjera lokale.	Norma e huamarrjes afatgjatë / totalit të të ardhurave të përgjithshme	0%

10	Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	I njëjti interpretim si më sipër. Raporti në këtë rast tregon qartë një varësi midis shërbimit të borxhit /shlyerjes me anë të burimeve të veta financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore	Norma e huamarrjes afatgjatë / të ardhurave të veta	0%
11	Raporti i huamarrjes afatshkurtër ndaj të ardhurave të përgjithshme	Afatshkurtër nën një vit Tregon aftësinë e njësisë vendore për të respektuar detyrimet afatshkurtra. Rritja e detyrimeve korrente afatshkurtra si % kundrejt të ardhurave në fund të vitit tregon një situatë negative në lidhje me likuiditetet dhe / ose problem me shpenzimet të cilat realizohen me borxh. Një raport i ulët tregon se borxhi afatshkurtër mund të shlyhet	Norma e huamarrjes afatshkurter / totalit të të ardhurave	0%

SEKRETAR

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULI

